

UNIVERSITETI I MITROVICËS

Fakulteti Ekonomik

Departamenti: Biznes dhe Menaxhment (Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)



PUNIM DIPLOME

Studente:

Sevdie ZEQIRI

Mentor:

Prof. Asoc. Dr: Esat DURGUTI

UNIVERSITETI I MITROVICËS

Fakulteti Ekonomik

Departamenti: Biznes dhe Menaxhment (Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)



Lënda: Menaxhment Financiar

Tema: Vlerësimi Ekonometrik i Inflacionit dhe Normës së Papunësisë në Rritjen Ekonomike – Rasti i Kosovës

Studente:

Sevdie ZEQRIRI

Mentor:

Prof. Asoc. Dr: Esat DURGUTI

PUBLIC UNIVERSITY OF MITROVICA «ISA BOLETINI»

FACULTY OF ECONOMICS

**DEPARTMENT: BUSINESS AND MANAGEMENT (SPECIALIZATION:
BANKING, FINANCE AND ACCOUNTING)**



BACHELOR THESIS

**ECONOMETRIC ASSESSMENT OF INFLATION AND UNEMPLOYMENT
RATE IN ECONOMIC GROWTH - THE CASE OF KOSOVO**

The candidate:

Sevdie ZEQRIRI

Mentor:

Prof. Asoc.Dr. Esat DURGUTI

Mitrovicë, Korrik 2023

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI EKONOMIK

**DEPARTAMENTI: BIZNES DHE MENAXHMENT (SPECIALIZIM: BANKA,
FINANCA DHE KONTABILITET)**



PUNIM DIPLOME

Lënda: Menaxhment Financiar

Titulli i punimit: “Vlerësimi Ekonometrik i Inflacionit dhe Normës së Papunësisë në Rritjen Ekonomike - Rasti i Kosovës”

Emri dhe mbiemri: Sevdie ZEQIRI

Statusi i studentit: I rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri): 2005031027

Niveli i studimeve: Baçelor

Departamenti: Biznes dhe Menaxhment (Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)

Programi i studimeve: Biznes dhe Menaxhment (Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)

Mentori i punimit: Prof.asoc.dr. Esat DURGUTI

Aprovuar prej komisionit:

- _____ Mentor

/Emri Mbiemri, Titulli /

- _____ Anëtar

/Emri Mbiemri, Titulli /

- _____ Anëtar

/Emri Mbiemri, Titulli /

Data e aprovimit: _____

FALENDERIME

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time më të thellë ndaj Zotit, për aftësitë intelektuale, mundësitë, forcën dhe qëndrueshmërinë e nevojshme për t'i dalë në fund këtij rrugëtimi akademik.

Iu jam përherë falënderuese prindërve dhe familjes sime, për mbështetjen e tyre të palëkundur, dashurinë e pakushtëzuar dhe besimin e pafund në potencialin tim. Sakrificat e tyre, inkurajimi dhe besimi i palëkundur në aftësitë e mia kanë qenë burim dhe forcë shtytëse e frymëzimit tim.

Shpreh falënderime të përzemërta për profesorët dhe stafin akademik, gatishmëria e të cilëve për të ndarë kohën, perspektivat dhe përvojat e tyre të vlefshme ka kontribuar pa masë në pasurimin e njohurive të mia.

Për më tepër, kam nderin dhe privilegjin të shpreh mirënjohjen time për mentorin e kësaj teze, Prof. Asoc. Dr. Esat A. DURGUTI, udhëzimi, mbështetja dhe përkushtimi i tij ndaj suksesit tim ka bërë një ndikim të pashlyeshëm si në zhvillimin tim personal ashtu edhe në atë profesional.

Në fund, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për të gjithë individët që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kanë kontribuar në përfundimin me sukses të kësaj teme.

Me këmbëngulje dhe punë të palodhshme e përkushtim në vazhdimësi, unë arrita të përfundoj studimet e mia, për të cilat sot kam një diplomë në dorë të cilën ia dedikoj familjes sime.

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT

Ky punim diplome është punim origjinal dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, për ndonjë gradë në këtë apo ndonjë universitet tjetër. Dhe nuk përmbanë, sipas njohurisë sonë, asnjë material të botuar ose shkruar nga një person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit.

STATEMENT OF ORIGINALITY

This thesis is our original work and has not been submitted, in whole or in part, for a degree at this or any other university. Nor does it contain, to the best of our knowledge and belief, any material published or written by another person, except as acknowledged in the text.

Emri/Name

Nënshkrimi/Signature

Data/Date

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Lista e tabelave | 8 |
| Lista e figurave | 8 |
| ABSTRAKT | 9 |
| ABSTRACT..... | 10 |
| HYRJE | 11 |
| Paraqitja e problemit | 11 |
| Formulimi dhe konteksti i punimit..... | 12 |
| 1. Faktorët makroekonomik që ndikojnë në rritjen ekonomike | 13 |
| 1.1. Rritja Ekonomike | 13 |
| 1.2. Inflacioni | 14 |
| 1.3. Norma e papunësisë | 14 |
| 1.4. Kursimet..... | 15 |
| 1.5. Remitancat personale | 16 |
| 2. Metodologjia | 18 |
| 2.1. Mbledhja e të dhënave | 18 |
| 2.2. Përpunimi i tyre..... | 19 |
| 2.3. Statistikat përshkruese..... | 20 |
| <i>Tabela 1: Statistikat përshkruese</i> | 20 |
| 2.4. Korrelacionet..... | 21 |
| 2.5. Analiza e regresionit | 21 |
| <i>Tabela 3: Analiza e regresionit.....</i> | 22 |
| Rekomandime | 25 |
| Referenca | 26 |

Lista e tabelave

| | |
|-----------------------------------|----|
| Tabela 1: Statistikat përshkruese | 20 |
| Tabela 2: Analiza e korrelacionit | 21 |
| Tabela 3: Analiza e regresionit | 22 |

Lista e figurave

| | |
|--|----|
| Figura1. Trendi i variablave ndër vite | 19 |
|--|----|

ABSTRAKT

Qëllimi i temës së diplomës është që të vlerësojë indikatorët makro ekonomik, respektivisht normën e inflacionit dhe normën e papunësisë në rritjen ekonomike, si dy ndër problemet më të mëdha me të cilat përballlet ekonomia e Kosovës.

Ky punim ka për qëllim vlerësimin ekonometrik të normës së inflacionit dhe normës së papunësisë në rritjen ekonomike, duke e përfshirë periudhën pesëmbëdhjetë vitet e fundit në Kosovë përmes literaturës teorike dhe empirike dhe synon të ofrojë një pasqyrë reale të këtyre dy problemeve nga prizmi teorik dhe shkencor. Për të argumentuar konstatimet e pohuara, ky punim ka përdorur metodologjinë e avancuar në aspektin ekonometrik. Metodologjia e aplikuar fillon me statistikat përshkruese, analizën e korrelacionit, testet e përshtatshmërisë së modelit, dhe në fund analiza e regresionit linear të shumëfishtë. Variablat e përfshirë në këtë punim diplome si e varur është rritja ekonomike, ndërsa variablat e pavarura janë norma e papunësisë, norma e inflacionit, kursimet dhe remitancave personale. Rritja ekonomike është procesi i rritjes së prodhimit dhe të të ardhurave në një vend, norma e papunësisë tregon nivelin e njerëzve të papunë në një ekonomi dhe inflacioni shpreh rritjen e vazhdueshme të çmimeve. Kursimet janë shuma e parave që individët ruajnë për të ardhmen, ndërsa remitancat janë paratë që dërgohen nga migrantët në vendet e tyre të origjinës.

Të gjeturat e analizës ekonometrike zbuluan se norma e inflacionit dhe norma e papunësisë kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike, ndërsa kursimet dhe remitancat personale rezultuan të kenë ndikim negativ në rritjen ekonomike.

Nga një këndvështrim risie dhe vlerash, ai aspiron të sigurojë prova empirike prej të cilave mund të përfitojnë studiues, akademikë apo organe politikëbërëse.

Fjalët kyçe: *papunësia, inflacioni, rritje ekonomike, Kosova.*

ABSTRACT

In this thesis, we will evaluate the rate of inflation and the rate of unemployment, two of the biggest problems faced by Kosovo.

This paper aims to evaluate the econometric rate of inflation and the rate of unemployment in economic growth for the last fifteen years in the region of Kosovo through theoretical and empirical literature and to provide a real overview of these two problems from a scientific-professional perspective.

The variables included in this study are dependent on economic growth, while the independent variables are the unemployment rate, inflation rate, savings, and personal remittances. Economic growth represents the process of increasing production and income in a country, the unemployment rate indicates the level of unemployed people in an economy, and inflation expresses the continuous increase in prices. Savings refer to the amount of money individuals save for the future, while personal remittances are the funds sent by migrants to their countries of origin.

The econometric analysis findings revealed that the inflation rate and unemployment rate have a positive impact on economic growth, while savings and personal remittances have a negative influence on economic growth.

From an innovative and values standpoint, it aspires to provide empirical evidence that can benefit researchers, academics, or policymaking institutions.

Key words: *unemployment rate, inflation rate, economic growth, Kosovo.*

HYRJE

Vlerësimi ekonometrik është një nga metodat më të rëndësishme në ekonominë sot dhe është i përdorur për të kuptuar marrëdhënien midis variablave ekonomike. Në këtë rast, do të flasim për vlerësimin ekonometrik të normës së inflacionit dhe normës së papunësisë në rritjen ekonomike. Norma e inflacionit dhe norma e papunësisë janë dy nga faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen ekonomike të një vendi. Inflacioni përcaktohet si rritja e çmimit të përgjithshëm të mallrave dhe shërbimeve në një periudhë të caktuar, ndërsa papunësia tregon numrin e njerëzve të papunë në një vend në një periudhë të caktuar. Këto dy faktorë kanë një ndikim të rëndësishëm në performancën e ekonomisë, dhe vlerësimi ekonometrik është një mjet i dobishëm për të kuptuar se si këta faktorë ndikojnë në rritjen ekonomike.

Ky punim synon të vlerësoj variablat kyçe si papunësia, inflacioni, kursimet dhe remitancat, me qëllim të kuptimit të ndikimit të tyre në rritjen ekonomike. Përdorimi i të dhënave sekondare nga Banka Botërore dhe përpunimi i tyre me programin statistikor i ka mundësuar analizën e thelluar të këtyre variablave dhe identifikimin e ndikimit reciprok që ato kanë në zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Fillimisht në kapitullin e parë bëjmë rishikimin e literaturës mbi indikatorët makroekonomikë të përfshirë në analizë, tutje kapitulli i dytë përshkruan metodologjinë e analizës ekonometrike të përdorur në këtë temë, më pas në kapitullin e tretë përmbledhim të gjeturat dhe diskutimet mbi indikatorët të cilët ndikojnë në rritjen ekonomike dhe në fund kapitulli i pestë përfshin konkluzionet dhe rekomandimet e nxjerra nga variablat e studiuara në këtë temë diplome.

Në funksion të realizimit në mënyrë profesionale është bërë strukturimi i këtij studimi në këtë mënyrë:

Paraqitja e problemit

Hipotezat tona të cilë janë parashtruar në pjesën e më poshtme dhe hulumtimet e mëparshme të realizuara në këtë disiplinë së bashku me pyetjen tonë kërkimore formon bazën e këtij punim diplome.

PK: Cili është ndikimi i normës së inflacionit dhe normës së papunësisë në rritjen ekonomike në Kosovë?

Në bazë të pyetjes kërkimore, kemi shtruar hipotezën:

H1: Norma e inflacionit ka ndikim negativ dhe statistikisht të rëndësishëm në rritjen ekonomike në Kosovë.

H2: Norma e papunësisë ka ndikim pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në rritjen ekonomike në rastin e Kosovës.

Formulimi dhe konteksti i punimit

Nëpërmjet metodologjisë së punimit, filluam me një përshkrim të detajuar të variablave kyçe, duke përfshirë papunësinë, inflacionin, kursimet dhe remitancat. Pastaj, kemi kryer analiza të thella të statistikave përshkruese për të zbuluar tendencat, shpërndarjet dhe variacionet e këtyre variablave në periudhën e studiuar. Përveç kësaj, kemi përdorur teknikat e analizës së korrelacionit për të zbuluar ndërveprimet dhe ndikimet e ndërsjella midis tyre. Një hap tjetër i rëndësishëm ka qenë përdorimi i modeleve regresion dhe testeve diagnostikuese për të vlerësuar ndikimin e papunësisë, inflacionit, kursimeve dhe remitancave në rritjen ekonomike.

Në fund, shpresojmë që rezultatet dhe rekomandimet tona të përdoren si bazë për zhvillimin e politikave ekonomike të qëndrueshme dhe të avancuara në përparimin e vendit tonë."

KAPITULLI I PARË: RISHIKIMI I LITERATURËS MBI INDIKATORËT MAKROEKONOMIK TË PËRFSHIRË NË ANALIZË

1. Faktorët makroekonomik që ndikojnë në rritjen ekonomike

Në ekonomi, faktorët makroekonomikë janë elemente që kanë ndikim të madh në zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë së një vendi (Rajesh, 2018), pasi që makroekonomia është degë e ekonomisë që studion sjelljen dhe performancën e ekonomisë në tërësi, pra është studim i ekonomisë në nivel agregat.

Faktorët makroekonomikë janë treguesit që tregojnë tendencën aktuale në ekonomi. Komponentë të ndryshëm të makroekonomisë. Me fjalë të tjera të gjithë ata tregues që ndihmojnë në analizimin e mjedisit makroekonomik njihen si faktorë makroekonomikë. (Kumar et al, 2022). Në këtë temë si faktorë makroekonomikë dominues në rritjen ekonomike kemi përcaktuar normën e inflacionit, normën e papunësisë, kursimet dhe remitancat personale për të cilat do japim sqarime në vazhdim.

1.1. Rritja Ekonomike

Rritja ekonomike është rritja e prodhimit të brendshëm bruto (PBB) të një vendi në një periudhë të caktuar (Howitt & Weil, 2018). Kjo mund të tregojë se ekonomia e një vendi është duke u zgjeruar dhe se ka rritje në aktivitetin ekonomik, të ardhurat, punësimin, dhe ndjeshëm ndikon në mirëqenien e popullsisë. Rritja ekonomike i referohet rritjes së treguesve sasiorë të një ekonomie, rritjes së prodhimit për kokë banori në një periudhë të caktuar. Gjatë viteve 1950 dhe 1960, zhvillimi ekonomik u vëzhgua si një seri fazash të njëpasnjëshme të rritjes ekonomike dhe "zhvillimi" u bë sinonim i "rritjes së shpejtë ekonomike agregate" (Todaro & Smith, 2015). Rritja ekonomike mund të shihet si një shenjë e zhvillimit dhe prosperitetit të një vendi, dhe mund të ndihmojë në përmirësimin e shërbimeve publike, si shëndetësia dhe arsimit.

Rritja ekonomike ndahet në rritje ekonomike ekstensive dhe intensive. Rritja ekstensive i referohet një rritjeje të prodhimit ekonomik që rezulton nga mobilizimi i më shumë prej tre faktorëve bazë të prodhimit: toka, puna dhe kapitali. Rritja intensive, nga ana tjetër, i referohet rritjes që nuk kërkon më shumë inpute faktorësh, por rezulton nga përdorimi më efikas i këtyre inputeve; kjo mund të rezultojë

nga teknologjia e re, një organizim social më efikas i prodhimit, ose nga rritja e njohurive që i bëjnë punëtorët më efikas. (Wilczynski, 1972).

1.2. Inflacioni

Inflacioni është një proces rritjeje të përgjithshme të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve në një ekonomi. (Maram, 2019) Në kuptimin më të thjeshtë, inflacioni thjesht do të thotë që gjërat kushtojnë më shumë në një periudhë të caktuar krahasuar me një periudhë tjetër. Inflacioni mund të shkaktohet nga shumë faktorë, përfshirë rritjen e kostos së prodhimit, rritjen e kërkesës për një produkt ose shërbim, si dhe rritjen e sasisë së parave në qarkullim. (Dornbusch et al, 1994)

Inflacioni mund të ketë ndikim të rëndësishëm në ekonominë e një vendi. Në një anë, inflacioni mund të rrisë të ardhurat e prodhuesve dhe tregtarëve dhe mund të nxisë investimet dhe rritjen ekonomike. Në anën tjetër, inflacioni mund të dëmtojë njerëzit që kanë të ardhura të vogla dhe investitorët që mbajnë monedha në vlerë. (Lipsey et al, 1999) Inflacioni gjithashtu mund të ndikojë në kursin e këmbimit, tregun e aksioneve dhe të ndikojë në stabilitetin e sistemit financiar. Për të kontrolluar inflacionin, bankat qendrore mund të ndërhyjnë në treg duke ndryshuar politikën monetare, siç janë rritja e normave të interesit dhe reduktimi i sasisë së parave në qarkullim. Qeveritë mund të ndërmarin politikë fiskale për të përmirësuar kushtet e biznesit dhe për të ndaluar rritjen e kostos së prodhimit. Megjithatë, kontrolli i inflacionit mund të jetë një sfidë e vështirë, dhe në disa raste, mund të jetë e nevojshme të ndërmerren masat e ashpër për të frenuar rritjen e inflacionit. (Maram; 2019).

Në përgjithësi, inflacioni është një proces i cili ndikon në shumë aspekte të ekonomisë së një vendi dhe duhet të kontrollohet për të siguruar stabilitetin e ekonomisë dhe mirëqenien e njerëzve.

1.3. Norma e papunësisë

Humbja e punës në ditët e sotme mund të jetë ngjarja më e vështirë ekonomike për jetën e një njeriu, jo vetëm që nënkupton një standard më të ulët jetese në të tashmen por nënkupton edhe një ankth për të ardhmen (Mankiew, 2007). I papunë konsiderohet çdo individ në moshë pune 16 e lart, i papunësuar, i aftë dhe i disponueshëm për të punuar dhe kërkon punë në mënyrë aktive. Të punësuarit dhe të papunësuarit përbëjnë forcën e punës apo nëngrupin e popullsisë që janë të aftë dhe të interesuar për të punuar. (Ndzwayiba, 2020).

Norma e papunësisë është një tregues i cili tregon shkallën e njerëzve të cilët janë të papunësuar në një vend ose regjion në një kohë të caktuar. Kjo normë llogaritet si raporti midis numrit të personave të papunësuar dhe numrit total të forcës punëtore në një vend të caktuar. (Kuznets, Simon; 1934). Një normë e lartë e papunësisë mund të ndikojë në shumë aspekte të një ekonomie, siç janë rritja e shpenzimeve publike për të ndihmuar njerëzit të cilët janë të papunësuar, ndikimi negativ në kërkesën për mallra dhe shërbime, dhe ulje në të ardhura mesatare për person. Pra, një normë e ulët e papunësisë mund të jetë e mirë për një ekonomi, pasi mund të ndikojë në rritjen e kërkesës për mallra dhe shërbime, në rritjen e produktivitetit dhe në rritjen e të ardhurave për person.

Për të përmirësuar normën e papunësisë, qeveritë mund të ndërmarrin politika aktive për t'i ndihmuar njerëzit të cilët janë të papunësuar të gjejnë punë dhe për të inkurajuar investime të reja në ekonominë lokale. Këto politika mund të përfshijnë subvencionet për kompanitë që krijojnë vende pune të reja, investimet në arsim dhe trajnim për të rritur produktivitetin dhe aftësitë e punëmarrësve, si dhe politikat fiskale dhe monetare për të inkurajuar rritjen ekonomike dhe rritjen e kërkesës për mallra dhe shërbime. Në përgjithësi, norma e papunësisë është një tregues i rëndësishëm për ekonominë e një vendi dhe duhet të kontrollohet për të siguruar stabilitetin ekonomik dhe mirëqenien e njerëzve.

1.4. Kursimet

Kursimet janë shuma e parave ose pasurive që një person ose një institucion ruajnë si një investim ose si një siguri financiare për të ardhmen. Kursimet mund të jenë në formë të para të mbajtura në një llogari bankare, investime në aksione, obligacione, fonde të investimeve, pronësi të paluajtshme, ose në forma të tjera të investimeve (Charkha dhe Jagdeesh, 2018)

Kursimet janë të rëndësishme për shumë arsye. Së pari, ato mund të përdoren për të siguruar një burim të sigurt të fondeve në raste emergjencash, siç janë humbjet e papritura të punës, dëmtime të pasurive, ose shpenzime të papritura mjekësore. Së dyti, kursimet mund të përdoren si një burim financiar për të ardhmen, për të siguruar një pension të sigurt ose për të përgatitur një fëmijë për universitetin. . Kursimet kanë një rol të rëndësishëm si financim alternativ kur një individ ka vështirësi për të ardhurat primare. (Jumena et al, 2022)

Një normë e lartë e kursimeve mund të konsiderohet si një tregues i mirëqenies financiare personale ose institucionale, pasi tregon aftësinë për të mbajtur një burim të mjaftueshëm të fondeve në rast emergjencash ose për të kryer investime të mëtejshme. Në anën tjetër, një normë e ulët e kursimeve

mund të tregojë një mungesë të ardhurash, një mungesë të aftësisë për të menaxhuar financat personale ose një mungesë të investimeve në burime të sigurta të ardhurash në të ardhmen.

Vendet me norma më të larta kursimi kanë pasur një rritje ekonomike më të shpejtë se ato me norma më të ulëta kursimi. Akumulimi i kapitalit krijon mundësi më të mëdha për prodhimin dhe produktivitetin e një vendi duke siguruar një rrjedhë shtesë të të ardhurave për vende si Kosova. (Ribaj & Mexhuani, 2021). Për të rritur normën e kursimeve, njerëzit mund të vendosin që të shpenzojnë më pak, të investojnë më shumë në produkte financiare të sigurta dhe të planifikojnë më mirë financat e tyre. Qeveritë mund të ndërmarrin politika për të inkurajuar kursimet, siç janë subvencionet për shpenzime të ardhshme, ulja e taksave mbi investimet në produkte të sigurta të ardhurash, dhe politika fiskale dhe monetare për të inkurajuar rritjen ekonomike dhe të ardhurat.

1.5. Remitancat personale

Remitancat personale janë shuma e parave që dërgohen nga një person në një vend në një person tjetër në një vend tjetër. Këto paratë shpesh dërgohen nga migrantët që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit të tyre të lindjes dhe dërgojnë para për familjet e tyre në vendin e tyre të origjinës.

Remitancat janë një burim shumë i rëndësishëm i ardhurash për shumë vende në zhvillim. Në disa vende, remitancat mund të jenë burimi më i madh i ardhurash dhe të ndihmojnë në mbajtjen e ekonomisë së tyre në lëvizje. (Shera and Meyer, 2013). Shumë njerëz dërgojnë remitancat për të ndihmuar familjet e tyre me shpenzimet e përditshme, për të paguar shkollat e fëmijëve, për të blerë shtëpi dhe pasuri të tjera, dhe për të mbështetur komunitetet lokale. (Ceesay et al, 2019)

Remitancat mund të ndikojnë në zhvillimin ekonomik në vende të ndryshme në disa mënyra. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, ato mund të ndihmojnë në rritjen e konsumit dhe investimeve, duke ndikuar në rritjen e GDP-së dhe të të ardhurave të brendshme të një vendi. Madje kohët e fundit qarkullimi i madh i remitancave ka rritur investimet të huaja direkte (IHD) në vendet në zhvillim. (Barajas et al, 2009) Ndërsa në mënyrë të zhdrejtë, ato mund të ndihmojnë në zbutjen e kushteve të varfërisë në disa komunitete, duke ofruar një burim të sigurt të ardhurash për familjet e tyre.

Megjithatë, remitancat mund të kenë edhe disa ndikime negative në ekonominë e një vendi. Në disa raste, ato mund të ndikojnë në çmime të larta në tregjet vendase, pasi që marrësit e remitancave mund të kenë një shumë të konsiderueshme të parave për t'u shpenzuar. Një sasi e madhe e remitancave mund gjithashtu të çojë në varësi të vazhdueshme nga këto burime të ardhurash, duke bërë vendin më të

varfër në të ardhmen nëse remitancat ndalojnë ose zvogëlohen. Në përgjithësi, remitancat janë një tregues i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik dhe marrëdhënieve ndërkombëtare dhe mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve në zhvillim.

KAPITULLI I DYTË: METODOLOGJIA E ANALIZËS EKONOMETRIKE

2. Metodologjia

Kjo temë diplome bazohet në normën e papunësisë dhe normën e inflacionit duke vlerësuar ndikimin e tyre në rritjen ekonomike duke përfshirë 15 observime nga viti 2008-2022 në Kosovë. Në këtë punim janë përcaktuar objektivat dhe variablat duke u bazuar në teoritë e zhvilluara deri më tani. Në këtë punim prioritetin më të madh e kanë variablat a) norma e papunësisë, b) norma e inflacionit dhe c) rritja ekonomike por gjithashtu përfshihen edhe variablat d) kursimet dhe e) remitancat personale. Për më tepër, në këtë punim janë aplikuar edhe analiza të korrelacionit dhe regresionit duke përfshirë teste diagnostifikuese për të vlerësuar shkallën e ndikimit.

Metodologjia e përdorura në këtë punim diplome është e kombinuar duke aplikuar metodat cilësore dhe metodat sasiore. Si metoda cilësore janë përdorë studimet e realizuara më herët në këtë disiplinë me qëllim të vëzhgimit nëse janë gjetur lidhje pozitive apo negative mes variablave të lartëcekura, ndërsa metoda sasiore përfshin grumbullimin e të dhënave statistikore në faqen e internetit të Bankës Botërore në lidhje me rritjen ekonomike, normën e inflacionit, normën e papunësisë, kursimet dhe remitancat personale. Gjithë burimet e përdorura janë burime të besueshme dhe serioze.


2.1. Mbledhja e të dhënave

Të dhënat e përdorura në këtë temë janë të dhëna sekondare, të shprehura në baza vjetore në përqindje me gjithsej 15 vëzhgime. Këto të dhënat janë siguruar nga data baza e Bankës Botërore, respektivisht indikatorët makroekonomik ([Indicators | Data \(worldbank.org\)](https://data.worldbank.org/)). Këto të dhëna janë kredibile pasi që janë të standardizuara për të gjitha shtetet në botë. Arsyeja e mos përfshirjes së periudhave të më hershme qëndron në atë se disa variablat nuk posedonin të dhënat adekuate. Variablat e përfshira janë:

- Rritja ekonomike,
- Inflacioni,
- Norma e papunësisë,
- Kursimet,

- Remitancat personale.

Figure 1. Trendi i variablave ndër vite



Në figurën 1, mund të shohim trendin e variablave ndër vite. Trendi sipas grafikonit tregon se rritja ekonomike është rreth 5 për qind në vitin 2008, rreth 6 për qind në vitin 2015 dhe afër 4 për qind në vitin 2022. Tutje, tek inflacioni mund të shohim një trend rënie prej vitit 2008 me mbi 14 për qind deri në vitin 2015 nën 1 për qind inflacion dhe prapë një rritje deri në vitin 2022 rreth 12 për qind. Trendi i normës së papunësisë ka vazhduar cdo herë me rënie përgjatë viteve që nga 2008 me 46 për qind, 32 për qind në vitin 2015 dhe 20 për qind në vitin 2022.

Gjithashtu, në grafikon shohim edhe trendin e kursimeve dhe remitancave personale, ku tek kursimet mund të shohim një trend në rënie prej 22 për qind në vitin 2008 në 21 për qind në vitin 2015, ku pastaj ka rritje të trendit deri në 25 për qind në vitin 2022, dhe për fund remitancat personale me rënie nga 20 për qind në vitin 2008 në 15 për qind në vitin 2015 dhe më pas rritje e trendit deri në 19 për qind në vitin 2022.

2.2. Përpunimi i tyre

Pasi që të dhënat janë nxjerrur nga databaza e Bankës Botërore, ato janë strukturuar dhe adaptuar formës së përpunimit, për t'i arritur objektivat e parashtruar në pyetjen kërkimore, si dhe verifikimit të

tyre sipas hipotezave të parashtruara. Për të përpunuar këto dhëna është shfrytëzuar program STATA, prej nga kam nxjerrë analizat si në vijim:

- Statistikat përshkruese,
- Analizën e korrelacionit,
- Analizën e regresionit.

2.3. Statistikat përshkruese

Gjetjet nga kjo temë do të fokusohen në ndikimin e normës së inflacionit dhe normës së papunësisë në rritjen ekonomike duke përfshirë rastin e Kosovës me 15 vëzhgime, e paraqitur në Tabelën 1. Nga të gjeturat mund të shohim se vlera mesatare e rritjes ekonomike është 4.37 për qind, me një devijim standard 3.32 për qind. Vlera më e lartë e arritur e rritjes ekonomike në këtë vend është 10.74 për qind dhe vlera më e ulët prej -5.34 për qind. Tutje, vlera mesatare e normës së inflacionit është 3.52 për qind me një devijim standard 4.60 për qind, vlerë më të lartë 14.2 për qind dhe vlerë më të ulët -2.83 për qind. Më pas, vlera mesatare e normës së papunësisë është 31.69 për qind me një devijim standard 8.07 për qind si dhe vlera më e madhe 47.5 për qind dhe vlera më e vogël 20.5 për qind.

Në këto gjetje përfshihen edhe kursimet dhe remitancat personale. Vlera mesatare e kursimeve në këtë vend është 24.95 për qind, devijimi standard 3.04 për qind, vlera më e madhe 29.28 për qind dhe vlera më e vogël e tyre është 20.31 për qind. Dhe në fund vlera mesatare e remitancave personale është 17.05 për qind me një devijim standard 2.10 për qind me vlerën më të madhe të tyre 21.05 për qind dhe vlerë më të vogël 14.75 për qind. Variabla me fokus më të madh është rritja ekonomike e cila paraqet variablën e varur në këtë temë e ku më pas do të studiohet ndikimi i variablave tjera të pavarura në të.

Tabela 1: Statistikat përshkruese

| | <i>Rritja ekonomike</i> | <i>Inflacioni</i> | <i>Norma e papunësisë</i> | <i>Kursimet</i> | <i>Remitancat personale</i> |
|--------------------|-------------------------|-------------------|---------------------------|-----------------|-----------------------------|
| <i>Observation</i> | 15 | 15 | 15 | 15 | 15 |
| <i>Mean</i> | 4.37 | 3.52 | 31.69 | 24.95 | 17.05 |
| <i>S.Deviation</i> | 3.32 | 4.60 | 8.07 | 3.04 | 2.10 |
| <i>Minimum</i> | -5.34 | -2.83 | 20.5 | 20.31 | 14.75 |
| <i>Maximum</i> | 10.74 | 14.2 | 47.5 | 29.28 | 21.05 |

Burimi: Kalkulimet e autorit

2.4. Korrelacionet

Matrica e koeficientëve të korrelacionit për variablat është dhënë në Tabelën 2. Në bazë të gjeturave në këtë analizë shohim se inflacioni ka korrelacion pozitiv me normën e papunësisë dhe me remitancat personale, ndërsa me kursimet ka ndërlidhje negative. Për me tepër, norma e papunësisë ka ndërlidhje negative me kursimet, ndërsa ka ndërlidhje pozitive me remitancat. Dhe së fundi, kursimet kanë shfaqur lidhje negative me remitancat personale. Si konkluzion i përgjithshëm, kjo analizë na tregon se të dhënat nuk kanë probleme me multikolinearitet dhe se modeli i përzgjedhur është adekuat.

Tabela 2: Analiza e korrelacionit

| | <i>Rritja ekonomike</i> | <i>Inflacioni</i> | <i>Norma e papunësisë</i> | <i>Kursimet</i> |
|-----------------------------|-------------------------|-------------------|---------------------------|-----------------|
| <i>Rritja ekonomike</i> | 1.0000 | | | |
| <i>Inflacioni</i> | 0.1674 | 1.0000 | | |
| <i>Norma e papunësisë</i> | 0.0684 | 0.0952 | 1.0000 | |
| <i>Kursimet</i> | -0.0960 | -0.2276 | -0.7081 | 1.0000 |
| <i>Remitancat personale</i> | -0.0717 | 0.4325 | 0.3601 | -0.2853 |

Burimi: Kalkulimet e autorit

2.5. Analiza e regresionit

Para se të bëjmë komentimin e rezultateve, vlen të theksohet se në kuadër të kësaj analize janë bërë edhe disa teste diagnostifikuese si Breusch Godfrey, test i cili vlerëson autokorrelacionin në gabimet që rrjedhin në një analizë regresioni dhe sipas rezultateve në tabelë shohim se vlera e tij është $p=4.707$ që nënkupton se të dhënat e aplikuara kanë autokorrelacion ndërmjet veti, rezultat ky i cili hedh poshtë hipotezën nul dhe vërteton hipotezën alternative në këtë punim.

Gjithashtu, për të analizuar korrelacionin serial është bërë edhe testi Durbin Watson, i cili vlerësohet në bazë të intervaleve, 0 deri 1.5 korrelacion serial negativ, 1.5 deri në 2.5 nënkupton se vlera e mbetur nuk ka korrelacion serial ose nuk ka autokorrelacioni ndërmjet vlerave të mbetura dhe mbi intervalin 2.5 të dhënat kanë korrelacion serial pozitiv. Të dhënat tona kanë një interval $DW=3.074$ që nënkupton se këto të dhëna kanë një korrelacion serial apo autokorrelacion mes vete. Faktori i inflacionit të variancës përdoret poashtu në këtë analizë për të testuar nëse të dhënat e aplikuara kanë probleme me shumëkolinearitetin dhe në rastin tonë vlera mesatare $VIF=1.77$, që dhëshmon se të dhënat tona nuk kanë probleme të tilla.

Nga analiza e rezultateve ekonometrike rezulton se koeficienti ($\beta=0.3677$), i cili tregon se ekziston një variacion mes variablës së varur dhe të pavarur prej 36.77 për qind. Ndërkohë, variablat e tjera paraqesin variacionin e mbetur. Këto rezultate dëshmojnë se është bërë zgjedhje adekuate e modelit në bazë të vlerës Chi2, përkatësisht $p=0.2094$.

Tabela 3: Analiza e regresionit

| <i>Variables</i> | <i>Coefficient</i> | <i>P>[z]</i> |
|-----------------------------|--------------------|-----------------------|
| <i>Inflacioni</i> | 0.17903*** | 0.003 |
| <i>Norma e papunësisë</i> | 0.04330* | 0.822 |
| <i>Kursimet</i> | -0.03196* | 0.949 |
| <i>Remitancat personale</i> | -0.35543** | 0.049 |
| <i>cons_</i> | 9.233291 | 0.022 |
| <i>R²</i> | | 0.3677 |
| <i>Chi2</i> | | Chi2=16.74 ; p=0.2094 |
| <i>Breusch Godfrey</i> | | 4.707 |
| <i>VIF mean</i> | | 1.77 |
| <i>Durbin Watson</i> | | 3.07358 |

Burimi: Kalkulimet e autorit

KAPITULLI I TRETË: TË GJETURAT DHE DISKUTIMET MBI INDIKATORËT TË CILËT NDIKOJNË NË RITJEN EKONOMIKE

Gjetjet tona të paraqitura në tabelën 2, na tregojnë se variablat me ndikim negativ janë kursimet në normën e inflacionit, në normën e papunësisë dhe në rritjen ekonomike dhe remitancat personale në rritjen ekonomike dhe në kursime. Ndërkaq, ndikim pozitiv kanë norma e inflacionit dhe norma e papunësisë në rritjen ekonomike dhe remitancat personale në normën e papunësisë.

Rezultatet ekonometrike të gjeneruara në këtë punim tregojnë se variabla e normës së inflacionit është statistikisht e rëndësishme me vlerën e koeficientit ($\beta=0.17903^{***}$) që paraqet një korrelacion pozitiv ($p=.003$) me një nivel besueshmërie 99.9 për qind. Kjo do të thotë se cdo rritje e normës së inflacionit ka një ndikim pozitiv në normën e rritjes ekonomike. Gjatë rishikimit të literaturës zbulojmë se rezultatet tona kanë lidhshmëri edhe me rezultatet e autorëve të tjerë si (Kryeziu dhe Durguti, 2019), (Mundell ; 1963) dhe (Tobin ; 1965)

Tutje, variabla e normës së papunësisë rezulton me vlerë koeficienti ($\beta=0.04330^*$), e cila gjithashtu paraqet një korrelacion pozitiv ($p=0.822$) por me nivel besueshmërie më të vogël prej 90 për qind. Sa i përket ndikimit që mund ta ketë norma e papunësisë në rritjen ekonomike tregojnë edhe autorë të tjerë se mund të ketë ndikim pozitiv por edhe ndikim të kundërt, pra cdo zvogëlim i normës së papunësisë ndikon në rritjen ekonomike dhe e kundërta. (Alhdiy et al., 2015), (Lee, 2000), (Fuad, 2011) dhe (Geidenhuys and Marinkov, 2007).

Rezultatet tona tregojnë poashtu ndikimin negativ të kursimeve me vlerë të koeficientit ($\beta= -0.03196^*$) me nivel besueshmërie 90 për qind. Ky studim ka rezultuar të ketë rezultate të kundërta me (Ribaj & Mexhuani, 2021), pasi që kursimet konsiderohen si faktorë shtytës për investime të ndryshme të cilat kanë ndikim të madh në rritjen ekonomike. Dhe në fund remitancat personale me vlerë të koeficientit ($\beta= -0.035543^{**}$) me nivel besueshmërie 95 për qind tregojnë një ndikim negativ në rritjen ekonomike, prej nga këto rezultate përputhen me (Barajas at al, 2009), prej nga mund të ketë konsekuencë reduktimin e ofertës së punës, pasi që të ardhurat nga remitancat mund të ulin interesimin për punë dhe produktivitetin nga familjet pranuese, gjithashtu mundësia për plotësimin e kushteve njerëzore nga jashtë përmes remitancave ndikon edhe në rritjen e papunësisë në vendin tonë.

KAPITULLI I KATËR: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ky punim ka synuar që të analizoj faktorët të cilët kanë ndikim në rritjen ekonomike, në kontekstin e ekonomisë së Kosovës, duke përfshirë periudhën 2008-2022. Gjithashtu, punimi ka aplikuar modelin e regresionit duke aplikuar faktorët (norma e inflacionit, norma e papunësisë, kursimet dhe remitancat personale). Nga rezultatet ekonometrike kemi konkluduar se norma e inflacionit ka një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike, ky rezultat mund të paraqesë një shkallë moderate të inflacionit e cila nxitë rritjen e tregut dhe investimet në vend dhe inkurajonë konsumatorët të blejnë më shumë që të stimulojnë aktivitetin ekonomik dhe gjithashtu një inflacion i ulët mund të jetë shkak për shmangien e deflacionit duke ruajtur kështu stabilitetin financiar.

Tutje, norma e papunësisë gjithashtu sipas rezultateve tona tregon një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike, rast ky i cili mund të ndodhë në situata kur tregu i punës është elastik dhe rritja e papunësisë mund të zvogëlojë koston e punës dhe njëkohësisht të nxitë rritjen e prodhimit në sektorët ku kostoja e punës është një faktor kyc. Gjithashtu, rritja e papunësisë mund të jetë një tregues për rritjen e fuqisë punëtore me kualifikim. Në këtë punim është përfshirë edhe variabla e kursimeve, ku sipas rezultateve kursimet kanë një ndikim negativ në rritjen ekonomike në Kosovë, e cila mund të paraqitet si shkak i pasigurisë financiare, ku një numër i konsiderueshëm i popullësisë preferojnë të harxhojnë më shumë dhe të sigurojnë jetë më të mirë për faktin se fondet e tyre mund të vjedhen apo keqpërdoren në forma të ndryshme.

Dhe në fund, remitancat personale rezultojnë gjithashtu me një ndikim negativ në rritjen ekonomike, i cili mund të ndodhë si pasojë e zvogëlimit të transferimeve monetare nga jashtë. Fillimisht, mos përdorimi i këtyre fondeve për investime në sektorë të ndryshëm, por vetëm për plotësimin e nevojave personale familjare ndikon në zvogëlimin e remitancave personale dhe gjithashtu remitancat personale sjellin edhe një kulturë jo të mirë të punës, pasi që financimi dhe plotësimi i nevojave të familjarëve ndikon drejtpërdrejtë në shkurajimin e tyre nga puna. Si cdo punim tjetër që ka sfidat e veta edhe kjo temë diplomë ka qenë mjaft emocionuese për mua dhe në të njëjtën kohë një mundësi për të demonstruar njohuritë dhe aftësitë që kam fituar gjatë këtij rrugëtimi akademik. Vështirësitë që unë i kam hasur kanë qenë kryesisht të vogla, fillimisht dilemë në përzgjedhjen e temës pastaj organizimi i kohës që rrjedhon më pas edhe në një masë të vogël stresi.

Kjo temë gjithashtu mund të implikoj legjislacionin e vendit në fjalë përmes politikës monetare dhe fiskale ku në varësi të normës së inflacionit dhe papunësisë, qeveritë ndërmarrin politika monetare dhe fiskale për të rregulluar ekonominë, pastaj inflacioni i kontrolluar ndihmon në ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit ku si pasojë shkallët e inflacionit të larta mund të dëmtojnë fuqinë blerëse të monedhës vendase dhe të ulin vlerën e kursit të këmbimit. Kjo mund të ndikojë në importet dhe eksportet dhe të çojë në kursime të papritura dhe kriza financiare.

Në rastet e inflacionit të lartë qeveritë përmes akteve të ndryshme ligjore që i nxjerrin mund të vendosin për rregullimin dhe mbajtjen nën kontroll të cmimeve të produkteve dhe shërbimeve të caktuara me qëllim që qytetarëve të iu ofrojë mbrojtje nga rritja e pakontrolluar e cmimeve.

Rekomandime

Në bazë të rezultateve të nxjerra nga ky punim, rekomandoj:

- Menaxhimin e inflacionit nga Qeveria nëpërmjet politikave dhe instrumenteve të saja Banka Qëndrore përmes një politike monetare të përshtatshme e cila ndikon në zbutjen dhe kontrollimin inflacionit,
- Menaxhimin dhe shfrytëzimin e të hyrave publike duke parandaluar kështu rritjen e suficitit buxhetor, i cili është një indikator për rritjen e normës së inflacionit
- Kontrolli efikas i normës së inflacionit stimulon konsumin dhe investimet
- Trajnimet e vazhdueshme të ndërlidhura me tregun e punës për aftësimin e të papunëve për të përmirësuar qasjen e tyre në një treg pune
- Inkurajimi i sektorëve që kanë potencial për të krijuar vende të reja pune
- Ofrimi i sigurisë financiare tek individët në mënyrë që të rriten kursimet
- Krijimi i një mjedisi të favorshëm për investime

Referenca

- Ahmet Mancellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici (2007). “Hyrtje në Ekonomi”
- Akutson, Seth, Abaka John, Messiah dhe Dalhatu, Araf. (2018). The Impact of Unemployment on Economic Growth in Nigeria: An Application of Autoregressive Distributed Lag (ARDL) Bound Testing. 1
- Alhdiy, Fouzeia, Johari, Fuadah, Mohd Daud, Siti Nurazira dhe Abdul Rahman, Asma. (2015). Short and Long Term Relationship between Economic Growth and Unemployment in Egypt: An Empirical Analysis. Mediterranean Journal of Social Sciences.
- Ana Brochadao dhe Victor Mendes. Savings and Financial Literacy (2021) Vol.1
- Babajić, Amra, Suljic, Mirza, Halilbegovic dhe Sanel. (2022). Economic Growth, Economic Development, and Poverty: A Bibliometric Analysis. Journal of Economic and Social Studies. 8. DOI: 10.14706/JECOSS21814
- Barajas, Adolfo & Chami, Ralph & Fullenkamp, Connel & Gapen, Michael & Montiel, Peter. (2009). Do Workers' Remittances Promote Economic Growth?. IMF Working Papers. 09. DOI:10.5089/9781451873009.
- Barajas, Adolfo, Chami, Ralph, Fullenkamp, Connel, Gapen, Michael dhe Montiel, Peter. (2009). Do Workers' Remittances Promote Economic Growth?. IMF Working Papers. 09. DOI: 10.5089/9781451873009.001.
- Ceesay, Ebrima, Sanneh, Tumani, Jawo, Amadou, Jarju, Madi dhe Jassey, Omar. (2019). Impact of Personal Remittances Received on Economic Growth in the Gambia. 117
- Charkha, Sanket dhe Lanjekar, Jagdeesh. (2018). Research Paper - “A STUDY OF SAVING AND INVESTMENT PATTERN OF SALARIED CLASS PEOPLE WITH SPECIAL REFERENCE TO PUNE CITY (INDIA)”
- Dean Karlan, Aishwarya Lakshmi Ratan dhe Jonathan Zinman. (2014) SAVINGS BY AND FOR THE POOR
- Durguti Esat dhe Kryeziu, (2020). Ndikimi i normës së inflacionit në rritjen ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor. Cogent Economics & Finance. Volume 1 (2). Pp.1-15
- Fetoshi, Granit, "Inflacioni" (2010). Theses and Dissertations
- Howitt, Peter dhe Weil, David. (2018). Economic Growth. DOI: 10.1057/978-1-349-95189-5_2314
- Ibrahim, Maram. (2019). INFLATION
- J. Wilczynski. Extensive and Intensive Growth (1972)

- Jumena, Bayu & Siaila, Steve & Widokarti, J.R.. (2022). Saving Behaviour: Factors That Affect Saving Decisions (Systematic Literature Review Approach). *JURNAL ECONOMIC RESOURCE*. 5. 217-235. 10.56750/jer.v5i2.365
- Kumar, Bipin & Saxena, Sakar & Rawat, Himali. (2022). *MACROECONOMIC*
- Lipsey, Richard, G. Chrystal dhe K. Alec, (1999). *Principles of Economics*, Oxford University Press: 51
- Mehmeti, Valtesa, (2016) "INFLACIONI, PAPUNËSIA DHE DEFICITI BUXHETOR". Theses and Dissertations
- Ndzwayiba, Anga'Wandisa. (2020). What Is Unemployment
- Pal, Rajesh. (2018). *Economic Growth, Inflation and Unemployment*
- Piotr Misztal. (2011) *THE RELATIONSHIP BETWEEN SAVINGS AND ECONOMIC GROWTH IN COUNTRIES WITH DIFFERENT LEVEL OF ECONOMIC DEVELOPMENT*
- Ribaj, Artur dhe Mexhuani, Fitim. (2021). The impact of savings on economic growth in a developing country (the case of Kosovo). *Journal of Innovation and Entrepreneurship*. DOI: 10.1186/s13731-020-00140-6.
- Rudiger Dornbusch, Stanley Fischer, and Richard Startz (1994), 6th edition. "Macroeconomics"
- Ruzima, Martin. (2016). *IMPACT OF INFLATION ON ECONOMIC GROWTH: A SURVEY OF LITERATURE REVIEW*
- Shera, Adela dhe Meyer, Dietmar. (2013). Remittances and their impact on Economic Growth. *Periodica Polytechnica Social and Management Sciences*. 21. 3. 10.3311/PPso.2152.
- SINDI DOCI. (2018) *UNEMPLOYMENT IN ALBANIA: A COMPARATIVE STUDY WITH NEIGHBOR COUNTRIES*
- Soylu, Özgür, Çakmak, İsmail dhe Okur, Fatih. (2018). Economic growth and unemployment issue: Panel data analysis in Eastern European Countries. *Journal of International Studies*. 11. 93-107. DOI:10.14254/2071-8330.2018/11-1/7
- Ssebulime Kurayish, Muvawala Joseph. (2019). Estimating the Cost of Unemployment to Uganda's Growth and Growth Trajectory 1980-2016: 'an auto-regressive distributed lag modelling approach'. *International Journal of Econometrics and Financial Management*.